



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Uprava za Poleprivredu, Sumarstvo i Ruralni Razvoj
Department of Agriculture, Forestry and Rural Development



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

2247 Më 10.07.2020
Dl. 20

RAHOVEC - ORAHOVAC

09Nr/2020 Rahovec, më datë: 10.07.2020

Për/Za/To:	Sanije Qelaj, Zyrtare e Larte për Mbrojtjen e Varieteteve të Bimëve dhe Kultura lavërtarë - MBPZHR
CC	z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
Nga/Od/From:	Berat Duraku, Drejtor i DBPZHR-së
Subjekti/Predmet/Subject:	Korrje – shirjet 2020

RAPORTI I SHTABIT KOMUNAL PËR FUSHATËN E KORRJE-SHIRJES 2020

Në komunën e Rahovecit fushata e korrje-shirjes së drithërave ka filluar me datën 30.06.2020 në fshatin Gur i Kuq, ndërsa me datë 01.07.2020 ka filluar edhe në vendbanime tjera.

Shtabi komunal në vazhdimësi ka përcjellë punën e korrjeve, duke mbledhur informatat e nevojshme në lidhje me sasinë dhe sipërfaqet e korrura në secilin vendbanim. Si në vitet e kaluara edhe në këtë vit aktivitetet rreth fushatës së korrje-shirjeve i kanë vetë fermerët dhe auto-kombajnërit.

Korrje-shirjet u organizuan varësisht nga konfiguracioni i terrenit dhe lëvizje të auto-kombajnave, që ishin mjaftueshëm të ardhur nga qytetet fqinje të Komunës sonë. Në të gjitha fshatrat është respektuar rendi i korrje-shirjeve, pos në ngastra të shpërndara dhe në ato bregore pati pritje në korrje.

Gruri kryesisht është dorëzuar në mullirin e M-Sillosit në fshatin Xërxë, në fshatin Çifllak si dhe në pikën grumbulluese në qytetin e Rahovecit. Fal kushteve të mira klimatike fushata e korrje-shirjes këtë vit është duke u zhvilluar me sukses, ku pritjet të përfundojë rreth datës 20.07.2020 përveç në disa ngastra që gjenden si të veçuar, fushata do të vazhdojë edhe për disa ditë. Sipas të dhënave të marrura nga fermerët, këtë vit rendimenti i grurit është i kënaqshëm si dhe cilësia është mjaftë e mirë.

Për të parë nga afër punën e korrje - shirjeve në terren ishte edhe Kryetari i Komunës z. Smajl Latifi bashkë me Drejtorin e DBPZHR-së z. Berat Duraku ku kanë vizituar auto-kombajnërat dhe fermerët kultivues të grurit, duke ju uruar punë të mbarë dhe të palodhshme.





Foto: Vizita tek fermerët e ndryshëm gjatë fushatës së korrje-shirjeve.

Të dhënat rreth korrje-shirjeve të drithërave:

Komuna	Rahovec
Data e fillimit te korrje-shirjeve	30.06.2020.
Numri i autokombajnave	35 vendor Mbi 15 të huaj
Sipërfaqet e korrura me grurë (ha)	1,000 ha
Rendimenti mesatar i grurit (kg/ha)	4.000 – 8.000 kg/ka.
Sipas analizave në Laboratorin e licencuar në M-Silloso në Xërxë, gjendja e grurit në komunën e ton është kjo:	Lagështia e kokrrës së grurit 9-10.4 %, Masa hektolitare 75-76, Pa pastërtia 3.5 - 4 %.
Vështirësit gjatë korrje shirjeve	Nuk kemi pasur vështirësi në fushatën e korrje shirjeve.

Shpresojmë që ditëve në vijim të mbizotëroj moti i mirë dhe të përfundojnë me suksese të gjitha korrjet e planifikuara.